



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 16.12.2019)

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:27 dhe mbaroi në orën 13:45.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|-----------------------------|--------------------------|
| <i>1. Naureda Llagami</i> | <i>(kryetare)</i> |
| <i>2. Maksim Qoku</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>3. Medi Bici</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>4. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Brunilda Kadi</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>6. Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Ilir Toska</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>8. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>9. Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>10. Erjon Muharremaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>11. Marçela Shehu</i> | <i>(anëtare)</i> |

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*

2. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.

3. Enida Muceku, Specialiste pranë Sektorit të Suportit të Menaxhimit të Çështjeve.

4. Helios Reveli, EURALIUS.

5. Rezart Alija, EURALIUS.

RENDI I DITËS:

1. Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Naureda Llagami: Atëherë, përshëndetje!

Po vijojmë me mbledhjen e datës 16.12.2019, mbledhje e cila është për shkak të urgjencës që kanë gjykatat lidhur me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta.

Në mbledhje janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Këshillit.

Lidhur me relativimin e këtij projekt-akti, ia jap fjalën zotit Ilir Toska.

Ilir Toska: Faleminderit!

Atëherë, deri ditën e sotme kanë ardhur disa kërkesa nga gjykata të shkallës së parë dhe të apelit, për nevoja që ato paraqesin për çështje të ndryshme gjyqësore të veçanta. Janë kërkesa nga 20 gjykata. Referuar kësaj, është përgatitur edhe një relacion për radhën e procedurave të shortit përmes të cilit propozohet që shorti të vijojë sipas këtij rendi, fillimisht gjykatat e apeleve sipas kësaj radhe: Gjykata e Apelit Korçë, Gjykata e Apelit Gjirokastër, Gjykata e Apelit Shkodër, Gjykata e Apelit Vlorë, Gjykata e Apelit Durrës dhe në fund Gjykata e Apelit Tiranë. Më pas të vijohet me gjykatat e shkallës së parë, fillimisht me gjykatat e shkallës së parë sipas juridiksionit të gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm, konkretisht gjykata e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Tiranë sipas kësaj radhe: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, më pas Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe në fund Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër. Më pas vijohet me gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Durrës: fillimisht Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe më pas Gjykata e

Rrethit Gjyqësor Kavajë. Më tej të vijojë shorti me gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin Gjykatës së Apelit Gjirokastrë: fillimisht Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë dhe më pas Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet. Më tej procedurat e shortit vijojnë me gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Korçë: që është vetëm Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec. Shorti të vijojë me gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Vlorë: që është vetëm Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnje. Në fund, shorti të vazhdojë me gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Shkodër: fillimisht me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, më pas me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë, më pas me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë, në fund Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës. Në fund të procedohet me shortin për gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin administrativ: që është vetëm për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë.

Jeni dakord me këtë radhë të procedurave të shortit?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Dakord.

Mirë atëherë, meqenëse Këshilli ra dakord për radhën e procedurave të shortit, vijojmë me shortin për **Gjykatën e Apelit Korçë**.

Gjykata e Apelit Korçë ka paraqitur nevojë në 44 çështje, nga të cilat 29 çështje janë në lëndë penale dhe pjesa tjetër, 15 çështje janë në lëndë civile.

Ndërsa nuk zbatohet mekanizmi i skemës së delegimit dhe është i padobishëm mekanizmi i transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i aplikueshëm vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, referuar të cilit Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon që:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 44 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jenë Gjykata e Apelit Tiranë, Gjykata e Apelit Durrës, Gjykata e Apelit Shkodër dhe Gjykata e Apelit Vlorë. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 44 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 15 gjyqtarë, nga të cilët 8 gjyqtarë nga Gjykata e Apelit Tiranë, 2 gjyqtarë nga Gjykata e Apelit Durrës, 3 gjyqtarë nga Gjykata e Apelit Shkodër dhe 2 gjyqtarë nga Gjykata e Apelit

Vlorë.

Në opcionin e pranimit të këtij propozimi, ndërsa gjyqtarët duhet të caktohen nga 4 gjykata apeli, duke patur në konsideratë numrin e gjyqtarëve që kërkohen të caktohen për secilën çështje, si dhe formimin më herët të trupit gjykues në disa prej tyre, për hapat e shortit që duhet të ndiqen, Komisioni propozon: Për çështjet penale:

1. Për 6 çështje, ato nr.2, nr.3, nr.4, nr.5, nr.6, dhe nr.16, për të cilat kërkohet caktimi i një gjyqtari, të caktohen 2 gjyqtarë, të cilët të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Seksionit Penal të Gjykatës së Apelit Tiranë, referuar kjo përbërjes së trupave gjykues në këto raste.

2. Për 2 çështje, ato nr.21 dhe nr.22, për të cilat kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve, të caktohen 2 gjyqtarë, të cilët të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Durrës.

3. Për 3 çështje, ato nr.8, nr.9 dhe nr.18, për të cilat kërkohet caktimi i një gjyqtari, ai të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Durrës të caktuar për çështjet nr.21 dhe nr.22.

4. Për 5 çështje, ato nr.1, nr.7, nr.10, nr.17 dhe nr.19, për të cilat kërkohet caktimi i një gjyqtari, për secilën nga ato të caktohet nga 1 gjyqtar, duke u përzgjedhur me short ndërmjet 2 gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Tiranë të caktuar sipas pikës 1, dhe 2 gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Durrës të caktuar sipas pikës 2.

5. Për çështjen nr.26, për të cilën kërkohen 3 gjyqtarë, ata të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Seksionit Penal të Gjykatës së Apelit Tiranë, të ndryshëm nga ata të caktuar sipas pikës 1.

6. Për 3 çështje, ato nr.27, nr.28 dhe nr.29, për të cilat kërkohen 3 gjyqtarë, ata të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Shkodër, ku secili nga gjyqtarët e përzgjedhur është dhe relator në një prej çështjeve.

7. Për 2 çështje, ato nr.20 dhe nr.23, për të cilat kërkohen 2 gjyqtarë, ata të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Seksionit Penal të Gjykatës së Apelit Tiranë, të caktuar sipas pikës 5.

8. Për 2 çështje, ato nr.24 dhe nr.25, për të cilat kërkohen 2 gjyqtarë, ata të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Shkodër, të caktuar sipas pikës 6.

9. Për 5 çështje, ato nr.11, nr.12, nr.13, nr.14 dhe nr.15, për të cilat kërkohet

caktimi i një gjyqtari, për secilën nga ato të caktohet nga 1 gjyqtar, duke u përzgjedhur me short ndërmjet 3 gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Tiranë të caktuar sipas pikës 5 dhe 3 gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Shkodër të caktuar sipas pikës 6.

Për çështjet civile:

1. Për 2 çështje, ato nr.43 dhe nr.44, për të cilat kërkohen 3 gjyqtarë, ata të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Seksionit Civil të Gjykatës së Apelit Tiranë.

2. Për 6 çështje, ato nr.30, nr.31, nr.32, nr.33, nr.35 dhe nr.38, për të cilat kërkohet 1 gjyqtar, ai të përzgjidhet me short nga 3 gjyqtarët e Seksionit Civil të Gjykatës së Apelit Tiranë të caktuar sipas pikës 1.

3. Për çështjen nr.42, për të cilën kërkohen 2 gjyqtarë, ata të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë.

4. Për 6 çështje, ato nr.34, nr.36, nr.37, nr.39, nr.40 dhe nr.41, për të cilat kërkohet 1 gjyqtar, ai të përzgjidhet me short nga 2 gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë të caktuar sipas pikës 3.

Më tej, Komisioni ka disa propozime për përjashtimin nga shorti, konkretisht të përjashtohen nga shorti kryetarët në detyrë të gjykatave respektive të apelit Durrës, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë, konkretisht: Ridvan Hado, Desart Avdulaj, Astrit Kalaja dhe Iliba Bezati.

Po kështu në shortimin e çështjeve për përzgjedhjen e gjyqtarëve nga Gjykata e Apelit Tiranë të përjashtohen nga shorti gjyqtarët që nuk janë në detyrë, me leje afatgjatë nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, konkretisht: Evjeni Sinojmeri dhe Gjin Gjoni.

Në shortimin e çështjeve penale sipas pikës I/1, të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Seksionit Penal të Gjykatës së Apelit Tiranë që kanë pengesë ligjore, ndërsa janë caktuar më herët për gjykimin e tyre, konkretisht: z. Andi Civici, z. Alaudin Malaj, znj. Shpresa Beçaj dhe znj. Fatmira Hajdari.

Në shortimin e çështjeve penale sipas pikës I/5, të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Seksionit Penal të Gjykatës së Apelit Tiranë që do të caktohen sipas pikës I/1.

Në shortimin e çështjeve penale për përzgjedhjen e gjyqtarëve nga Gjykata e Apelit Durrës, të përjashtohet nga shorti gjyqtarja e kësaj gjykate që ka pengesë ligjore, ndërsa është caktuar më herët për gjykimin e tyre, konkretisht: znj. Anita Mici.

Në shortimin e çështjeve penale për përzgjedhjen e gjyqtarëve nga Gjykata e

Apelit Shkodër, të përjashtohet nga shorti gjyqtarja e kësaj gjykate që ka paraqitur dorëheqje, e cila është në proces shqyrtimi, konkretisht: znj. Marina Raboshta

Në shortimin e çështjeve civile sipas pikës II/1, të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Seksionit Civil të Gjykatës së Apelit Tiranë të cilët janë caktuar më herët për gjykimin e 10 apo më shumë çështjeve gjyqësore në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, konkretisht: znj. Elbana Lluri, znj. Zegjine Sollaku, z. Gramoz Levanaj, znj. Maria Qirjazi dhe z. Artur Kalaja.

Në shortimin e çështjeve civile për përzgjedhjen e gjyqtarëve nga Gjykata e Apelit Vlorë, të përjashtohet nga shorti gjyqtarët e kësaj gjykate që kanë pengesë ligjore, ndërsa janë caktuar më herët për gjykimin e njëres prej tyre, konkretisht: z. Sokol Ngresi dhe z. Petrit Aliaj.

Këto ishin propozimit. Nëse jeni dakord.

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Atëherë, meqenëse Këshilli është dakord, mund të vazhdojmë me procedurat e shortit. Shorti zhvillohet në mënyrë elektronike.

Valbona Bako: Atëherë, për çështjet të cilat janë në pikën 1 të propozimit të Komisionit, gjyqtarët e përzgjedhur janë: për çështjen nr. 104, gjyqtare Valdete Hoxha, për çështjen me nr. 89 Genti Shala, për çështjen nr. 83 Valdete Hoxha, për çështjen nr. 84 Genti Shala, për çështjen nr. 135, gjyqtare Valdete Hoxha, dhe për çështjen nr. 92, gjyqtari Genti Shala.

Për çështjet sipas propozimit me nr. 2 dhe nr. 3: për çështjen nr. 176 zgjidhen gjyqtarët Valbon Çekrezi dhe Tritan Hamitaj, për çështjen nr. 111 gjyqtari Valbon Çekrezi, për çështjen nr. 189 Tritan Hamitaj dhe Valbon Çekrezi, për çështjen nr. 108 Tritan Hamitaj, për çështjen nr. 163 Valbon Çekrezi.

Për propozimin nr. 4 në relacion, gjyqtarët e përzgjedhur janë: për çështjen nr. 171 gjyqtari Izet Dushaj, për çështjen nr. 162 gjyqtar Tritan Hamitaj, për çështjen nr. 122 Valbon Çekrezi.

Ilir Toska: Atëherë, anulohet shorti, se nuk është hedhur saktë propozimi. Hidhe saktë propozimin!

Valbona Bako: Pra për propozimin nr. 4 marrin pjesë në short dy gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë që u përzgjedhën në pikën 1 të propozimit dhe dy gjyqtarët e

apelit Durrës që u zgjodhën në pikën 2 dhe 3. Për çështjen nr. 122 përzgjidhet gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë Valdete Hoxha, për çështjen nr. 162 Valbon Çekrezi i apelit Durrës, për çështjen nr. 138 Tritan Hamitaj, për çështjen nr. 171 gjyqtari Genti Shala dhe për çështjen nr. 131 gjyqtarja Valdete Hoxha.

Për propozimin nr. 5 duhet të heqim dy gjyqtarët e apelit Tiranë që u caktuan, pra Genti Shala dhe Valdete Hoxha. Për propozimin nr. 5 dhe propozimin nr. 7 në relacion. Për çështjen nr. 11/5/2019.. për çështjen nr. 210 zgjidhen gjyqtarët Andi Civici (relator), anëtarë Shkëlqim Mustafa dhe Fatmira Hajdari, për çështjen nr. 159 zgjidhen gjyqtarët Andi Civici dhe Shkëlqim Mustafa; për çështjen nr. 130 zgjidhen gjyqtarët Fatmira Hajdari dhe Andi Civici.

Për pikën 6 dhe 8 të relacionit, nga shorti rezulton se për çështjen nr. 148 gjyqtarët e përzgjedhur janë Vojsava Osmanaj dhe Lindita Hoxha të apelit Shkodër, për çështjen nr. 215 Selim Kryeziu dhe Vojsava Osmanaj, për çështjen nr. 197 Lindita Hoxha (relatore) dhe anëtarë Selim Kryeziu dhe Vojsava Osmanaj, për çështjen 208 Selim Kryeziu (relator) Lindita Hoxha dhe Vojsava Osmanaj (anëtarë) dhe për çështjen nr. 216 Vojsava Osmanaj (relatore) dhe Lindita Hoxha dhe Selim Kryeziu (anëtarë).

Për çështjen nr. 147 Lindita Hoxha, për çështjen nr. 153 Selim Kryeziu, për çështjen 128 gjyqtare Fatmira Hajdari dhe për çështjen nr. 151 gjyqtare Vojsava Osmanaj.

Ilir Toska: Janë 5 çështje.

(Rihidhet edhe një herë shorti për propozimin nr. 9 në relacion.)

Valbona Bako: Për çështjen 151 gjyqtare Lindita Hoxha, për çështjen 152 gjyqtare Vojsava Osmanaj, për çështjen 147 gjyqtar Selim Kryeziu, për çështjen 128 gjyqtari Andi Civici, për çështjen 153 gjyqtare Fatmira Hajdari.

Për çështjet civile, sipas pikës domethënë propozimi nr. 1 dhe nr. 2 në relacion, që janë gjithsej 8 çështje, i marrë nga Seksioni Penal.. nga Seksioni Civil, më fal: për çështjen nr. 409 gjyqtar Artur Gaxha, për çështjen 316 gjyqtare Elona Toro, për çështjen 347 gjyqtare Edlira Petri (relatore) dhe anëtarë gjyqtarët Artur Gaxha dhe Elona Toro, për çështjen nr. 48 gjyqtare Edlira Petri, për çështjen 12/37 gjyqtar Artur Gaxha (relator) dhe anëtarë gjyqtarët Elona Toro dhe Edlira Petri, për çështjen 377 gjyqtar Artur Gaxha, për çështjen nr. 64 gjyqtare Elona Toro dhe për çështjen 312 gjyqtare Edlira Petri.

Po, janë zgjedhur gjyqtarët Klodiana Gjyzari dhe Skënder Damini.

Gjyqtarët Klodiana Gjyzari dhe Skënder Damini për propozimin nr. 3.

Tani për propozimin nr. 4 do hidhet shorti ndërmjet dy gjyqtarëve të zgjedhur pra Klodiana Gjyzari dhe Skënder Damini. Gjyqtarja e përzgjedhur është Klodiana Gjyzari, pra për çështjen nr. 51, për çështjen nr. 7, për çështjen nr. 55, për çështjen nr. 45, 412 dhe për çështjen nr. 43.

Ilir Toska: Duhet të zgjidhet mes të dyve.

Anulohet. Shorti duhet të zgjidhet mes dy gjyqtarëve të caktuar për propozimin për çështjen/për rastin 3, pra Klodiana Gjyzari dhe Skënder Damini. 6 çështjet sipas propozimit 4, duhet të ndahen mes tyre.

Ilir Toska: Atëherë, për propozimin nr. 4 për sa i përket 6 çështjeve civile të cilat duhet të ndahen mes dy gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Vlorë, shorti do të bëhet në mënyrë manuale, për shkak se sistemi elektronik ka probleme dhe nuk mund të bëjmë këtë procedurë shorti për këto 6 çështje.

Valbona Bako: Atëherë për çështjen nr. 39, Klodiana Gjyzari. T'i bëj treshetre. Pra, 39, 41 dhe 36. Për gjyqtarin Skënder Damini tre çështjet e tjera: 37, 34 dhe 40.

Ilir Toska: Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Apelit Korçë.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Apelit Gjirokastrë**. Gjykata e Apelit Gjirokastrë ka paraqitur nevojë në 6 çështje, nga të cilat 3 në lëndë penale dhe 3 në lëndë penale. Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor "Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme", referuar të cilit Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon: Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtarët që do të caktohet për gjykimin e 6 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jenë Gjykata e Apelit Korçë dhe Gjykata e Apelit Vlorë.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 6 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 3, nga të cilët 1 nga të cilët nga Gjykata e Apelit Korçë dhe 2 nga Gjykata e Apelit Vlorë.

Në opsionin e pranimit të propozimit si më lart, propozimet vijuese të Komisionit janë:

1. Për 3 çështje, ato nr.3, nr.4 dhe nr.5, për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, në konsideratë të formimit aktualisht të trupave gjykues me 2 gjyqtarë të Gjykatës së Apelit Korçë, si i përzgjedhur nga shorti të konsiderohet gjyqtari tjetër në detyrë i Gjykatës së Apelit Korçë, konkretisht gjyqtari Stavri Kallço.

2. Për çështjet nr.1 dhe nr.2, për të cilat kërkohen 2 gjyqtarë, ata të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë.

3. Për çështjen civile nr.6, për të cilën kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, ai të përzgjidhet me short midis 2 gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Vlorë të caktuar sipas pikës 2.

Më tej komisioni ka propozime sa i përket përjashtimeve nga shorti, konkretisht: për kryetaren në detyrë zëvendëskryetaren e Gjykatës së Apelit Vlorë, znj. Iliba Bezati.

Si dhe në shortimin e çështjeve për përzgjedhjen e gjyqtarëve nga Gjykata e Apelit Vlorë të përjashtohen nga shorti 2 gjyqtarët e kësaj gjykate që do të caktohen për gjykimin e çështjeve të veçanta në Gjykatën e Apelit Korçë, që më lart rezultoi të ishin gjyqtarët Klodiana Gjyzari dhe Skënder Damini.

Jeni dakord me këto propozime?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Dakord. Meqenëse Këshilli është dakord me propozimet e Komisionit, vijojmë me procedurën e shortit elektronik.

Valbona Bako: Për çështjet 3, 4 dhe 5 është gjyqtari Stavri Kallço, -sipas propozimit.

Ndërsa për çështjen nr. 146 gjyqtare Margarita Buhali.

Për çështjen nr. 96 gjyqtarët Petrit Aliaj dhe Margarita Buhali.

Dhe për çështjen nr. 88 Petrit Aliaj dhe Margarita Buhali.

Ilir Toska: Mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Apelit Gjirokastrë.

Vazhdojmë me procedurat e shortit për **Gjykatën e Apelit Shkodër.**

Gjykata e Apelit Shkodër ka paraqitur nevojë në 7 çështje të cilat janë të gjitha në lëndë penale. Edhe në këtë rast është i aplikueshëm vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, referuar të cilit Komisioni ka këto propozime: Gjykata nga

duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që do të caktohet për gjykimin e 7 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Durrës dhe Gjykata e Apelit Tiranë.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 7 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 3.

Në opsionin e pranimit të propozimit si më lart, propozimet vijuese të Komisionit janë:

1. Për çështjet nr.1, nr.2 dhe nr.4, për të cilat kërkohet 1 gjyqtar, ai të përzgjidhet me short ndërmjet gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Tiranë.

2. Për çështjen nr.7, për të cilën kërkohen 2 gjyqtarë, ata të përzgjidhen me short ndërmjet gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Durrës.

3. Për çështjet nr.3, nr.5 dhe nr.6, për të cilat kërkohet 1 gjyqtar, për secilën nga ato ai të përzgjidhet me short ndërmjet gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Durrës që do të caktohen sipas pikës 2.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, Komisioni ka këto propozime: të përjashtohen nga shorti kryetarët në detyrë të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe të Gjykatës së Apelit Durrës, konkretisht: z.Ridvan Hado dhe z.Desart Avdulaj.

Në shortimin e çështjeve për përzgjedhjen e gjyqtarëve nga Gjykata e Apelit Tiranë të përjashtohen nga shorti gjyqtarët që nuk janë në detyrë, me leje afatgjatë nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë: znj. Evjeni Sinojmeri dhe z. Gjin Gjoni.

Në shortimin e çështjeve për përzgjedhjen e gjyqtarëve nga Gjykata e Apelit Tiranë të përjashtohen nga shorti 8 gjyqtarët e kësaj gjykate që do të caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Apelit Korçë.

Po kështu, në shortimin e çështjes për përzgjedhjen e gjyqtarit nga Gjykata e Apelit Durrës të përjashtohen nga shorti 2 gjyqtarët e kësaj gjykate që do të caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Apelit Korçë.

Mund të vijojmë me procedurat e shortit elektronik, duke reflektuar gjyqtarët e apelit Tiranë dhe apelit Durrës që u caktuan në Gjykatën e Apelit Korçë.

Valbona Bako: Për propozimin nr. 1 që do t'i marrim nga Gjykata e Apelit Tiranë, do heqim gjyqtarët të cilët u përzgjedhën në Gjykatën e Apelit Korçë që janë: Elona Toro, Valdete Hoxha, Andi Civici, Shkëlqim Mustafa dhe Fatmira Hajdari.

Ilir Toska: Janë 8 gjyqtarë.

Valbona Bako: Pra ishte Valdete Hoxha, Andi Civici, Genti Shala, Shkëlqim Mustafa, Fatmira Hajdari, Elona Toro, Artur Gaxha dhe Edlira Petri.

Gjyqtarja e përzgjedhur është Flutura Skënderi, për çështjen nr. 288, 538 dhe 1699.

Për çështjen nr. 70/674/1335 është gjyqtarja Anita Mici.

Për çështjen nr. 644 është gjyqtari Izet Dushaj.

Për çështjen nr. 234/1166 janë gjyqtarët Anita Mici dhe Izet Dushaj.

Për çështjen nr. 460 është gjyqtarja Anita Mici.

Mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Apelit Shkodër.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Apelit Vlorë**. Gjykata e Apelit Vlorë ka paraqitur nevojë në 4 çështje, që janë të katra në lëndë penale.

Në këtë rast është i zbatueshëm vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, referuar të cilit Komisioni propozon që:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 4 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Gjirokastër.

Numri i gjyqtarëve të jetë 3.

Në opsion të pranimit të propozimit si më lart, propozimet vijuese të Komisionit janë:

1. Për çështjen nr.4, për të cilën kërkohen 3 gjyqtarë, ata të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Gjirokastër.

2. Për 3 çështje, ato nr.1, nr.2, dhe nr.3, për të cilat kërkohet 1 gjyqtar, për secilën nga ato ai të përzgjidhet me short ndërmjet dy gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Gjirokastër të caktuar si anëtar për çështjen nr.4.

Një propozim është për përjashtim nga shorti, të kryetarit në detyrë të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, z.Dritan Banushi.

Jeni dakord me këto propozime?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Dakord.

Atëherë, vijojmë me procedurat e shortit elektronik për shpërndarjen e këtyre çështjeve.

Valbona Bako: Atëherë, fillimisht hidhet shorti për çështjen nr. 4 që kërkon tre gjyqtarë – të cilët janë Enton Dhimitri (relator), Izet Salaj dhe Miranda Andoni.

Për çështjen nr. 773 gjyqtari Izet Salaj.

Për çështjen nr. 702 gjyqtare Miranda Andoni.

Për çështjen nr. 635 (*në fakt është nr. i kërkesës, kurse nr. i çështjes është 611*) gjyqtari Izet Salaj.

Ilir Toska: Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Apelit Vlorë.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Apelit Durrës**. Ka paraqitur nevojë për 1 çështje që është në lëndë penale.

Edhe në këtë rast është i aplikueshëm vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, referuar të cilit Komisioni propozon që:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Apelit Vlorë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1.

Në opsionin e pranimit të këtij propozimi, ka një propozim vetëm për përjashtimin nga shorti, sa i përket kryetares në detyrë të Gjykatës së Apelit Vlorë, zonjës Iliba Bezati dhe të 2 gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë që do të caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Apelit Korçë që ishin Klodiana Gjyzati dhe Skënder Damini.

Jeni dakord me këto propozime?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Dakord.

Meqenëse Këshilli është dakord me propozimin e Komisionit, vijojmë me procedurat e shortit elektronik.

Valbona Bako: Gjyqtari Hysen Saliko.

Ilir Toska: Me kaq mbyllet edhe procedura e shortit për Gjykatën e Apelit Durrës.

Vazhdojmë me procedurat e shortit për **Gjykatën e Apelit Tiranë** që ka paraqitur nevojë në 1 çështje që është në lëndë civile.

Edhe në këtë rast është i zbatueshëm vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, referuar të cilit Komisioni propozon që:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Apelit Korçë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për këtë çështje, të jetë 2 sa është nevoja e Gjykatës së Apelit Tiranë.

Në këtë rast Komisioni ka një propozim për mospërfjashtim nga shorti të kryetarit në detyrë zëvendëskryetarit të Gjykatës së Apelit Korçë zotit Stavri Kallço, referuar faktit të ngarkesës së ulët të Gjykatës së Apelit Korçë si dhe numrit të kufizuar të kësaj gjykate.

Jeni dakord me këto propozime?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Dakord.

Mirë atëherë, vazhdojmë me procedurat e shortit elektronik.

Valbona Bako: Etleva Temo dhe Stavri Kallço.

Ilir Toska: Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Apelit Tiranë.

Vazhdojmë me gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, për **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë**. Ka paraqitur nevojë në 4 çështje, që janë 3 në lëndë penale dhe 1 në lëndë civile. Referohet që në 2 çështje më herët, 1 në lëndë penale dhe 1 në lëndë civile të jenë pushuar gjykimet e çështjeve nga gjyqtarët e caktuar nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë apo Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Edhe në këto raste është i zbatueshëm vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, referuar të cilit Komisioni propozon që:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 4 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe numri i gjyqtarëve për gjykimin e këtyre 4 çështjeve, të jetë 2.

Në opsionin e pranimit të propozimit si më lart, duke mbajtur duke mbajtur në konsideratë dhe vendimin nr. 238/1/a, datë 24.12.2008, “Për procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore”, të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, që vijon të zbatohet për aq sa nuk vjen në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, për hapat e shortit që duhet të ndiqen, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka këto propozime:

Për çështjet penale: Për çështjen nr.2, për të cilën kërkohet 1 gjyqtar, në respektim të vendimit si më lart të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, si i përzgjedhur nga shorti të konsiderohet gjyqtari Kreshnik Omari, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili është caktuar më herët për gjykimin e kësaj çështjeje, ndërsa në atë rast ka vendosur deklarimin e papranueshëm të kërkesës për shkak të heqjes dorë nga ajo prej kërkuesit. Për çështjet nr.1 dhe nr.3, për të cilat kërkohet 1 gjyqtar, ai të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e Seksionit Penal të Çështjeve Penale të Themelit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Sa i përket çështjeve civile: Për çështjen nr.4, për të cilën kërkohet 1 gjyqtar, në respektim të vendimit si më lart të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, si i përzgjedhur nga shorti të konsiderohet gjyqtarja Klorinda Çela, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila është caktuar më herët për gjykimin e kësaj çështjeje, ndërsa në atë rast ka vendosur pushimin e gjyimit të saj.

I vetmi propozim i Komisionit është për përjashtim nga shorti të kryetarit në detyrë zëvendëskryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë z. Petrit Çomo që është pjesë e Seksionit Penal të Çështjeve Penale të Themelit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku bëjnë pjesë edhe gjyqtarët Arben Mickaj, Gerd Hoxha, Kreshnik Omari, Shefkije Demiraj, Ardiana Bera, Bedri Qori, Vjollca Spahiu, Ahmet Metalia, Sokol Pasho dhe Kastriot Gramshi.

Jeni dakord me këto propozime?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Mirë atëherë, vijojmë me procedurat e shortit elektronik.

Valbona Bako: Kemi short vetëm për çështjen 1 dhe 3 dhe gjyqtari i përzgjedhur është Sokol Pasho për gjykimin e të dyja çështjeve.

Ilir Toska: Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin**. Ka paraqitur nevojë në 3 çështje në lëndë penale.

Edhe në këtë rast është i aplikueshëm vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, referuar të cilit Komisioni propozon që:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 3 çështjeve gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat dhe numri i gjyqtarëve për gjykimin e këtyre çështjeve, të jetë 2.

Në opSION të pranimit të këtij propozimi, ka vetëm një propozim sa i përket mospërfjashtimit nga shorti të kryetarit në detyrë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, z. Artan Çupi.

Jeni dakord?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Dakord.

Vazhdojmë me shortin elektronik atëherë.

Valbona Bako: Atëherë, për çështjen që kërkon 2 gjyqtarë (572 - 367) janë gjyqtarët Ali Koleci dhe Rexhep Karaj, për çështjen nr. 617 - 213 që kërkon 1 gjyqtar është Ali Koleci dhe për çështjen 663 – 222 është gjyqtari Rexhep Karaj.

Ilir Toska: Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër**. Ka paraqitur nevojë në 1 çështje penale. Kërkohen 2 gjyqtarë.

Edhe në këto raste është i zbatueshëm vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, referuar të cilit Komisioni propozon që:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje, të jetë 2, saç është nevoja.

Edhe në këtë rast propozohet të mos përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, zoti Artan Çupi, në kushtet e ngarkesës relativisht të ulët të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat dhe numrit të kufizuar të gjyqtarëve.

Jeni dakord me këtë propozim?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Dakord.

Meqenëse Këshilli është dakord, vazhdojmë me procedurat e shortit.

Valbona Bako: Murat Lleshi dhe Artan Çupi.

Ilir Toska: Me kaq mbyllet procedura e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër.

Vazhdojmë me procedurat e shortit për **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan**. Ka paraqitur nevojë në 1 çështje që është në lëndë civile.

Edhe në këtë rast është i zbatueshëm vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, referuar të cilit Komisioni propozon që:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje, të jetë 1.

Në këtë rast ka vetëm një propozim për përjashtim nga shorti të kryetares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, zonjës Entela Shedula.

Jeni dakord?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Dakord.

Mirë atëherë, vazhdojmë me procedurat e shortit elektronik, në kushtet kur Këshilli është dakord me propozimet.

Valbona Bako: Luan Lusha.

Ilir Toska: Me kaq mbyllet procedurat e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Vazhdojmë me procedurat e shortit për **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë**. Ka paraqitur nevojë në 1 çështje që është në lëndë penale. Kërkohet 1 gjyqtar.

Edhe në këtë rast është i zbatueshëm vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, referuar të cilit Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon që:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohet për gjykimin e kësaj çështjeje, të jetë 1, saç është nevoja.

Propozimet vijuese kanë të bëjnë me përjashtimet nga shorti. Referohet të përjashtohet nga shorti gjyqtarët e seksionit penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës që kanë pengesë ligjore, disa janë caktuar më herët për gjykimin e kësaj çështjeje, konkretisht gjyqtarët Eda Kaja dhe Paulin Çera.

Jeni dakord?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Meqenëse Këshilli është dakord, vijojmë me procedurat e shortit, ndërkohë që duhet të përjashtohen nga shorti dy gjyqtarët e përmendur më lart.

Valbona Bako: Besjana Garxenaj.

Ilir Toska: Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Vazhdojmë me procedurat e shortit në **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë**. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë ka paraqitur nevojë në 2 çështje, 1 në lëndë penale dhe 1 në lëndë civile.

Edhe në këtë rast është i zbatueshëm vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, referuar të cilit Komisioni ka këto propozime:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jenë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohet për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 3.

Konkretisht, për hapat e shortit, Komisioni ka këto propozime: Për çështjen nr. 1 për të cilën kërkohen 2 gjyqtarë, ata të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet.

Për çështjen nr. 2 për të cilën kërkohet 1 gjyqtar, ai të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë apo edhe të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, të ndryshëm nga ato që do caktohen sipas pikës 1.

Në këtë rast propozohet të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, të cilët janë caktuar për çështjen nr. 2, të cilët janë caktuar më herët në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër për gjykimin e 2 çështjeve të tjera gjyqësore të veçanta që kanë lidhje me këtë çështje që është në nevojë, konkretisht gjyqtarët Nevrie Duka dhe Suela Xhani.

Nga ana tjetër, Komisioni propozon të mos përjashtohen nga shorti kryetarët në detyrë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, konkretisht Sokol Pina dhe Dritan Hasani.

Jeni dakord me propozimet?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Meqenëse Këshilli është dakord, vazhdojmë me procedurat e shortit elektronik.

Valbona Bako: Atëherë, për çështjen nr.1 që kërkon 2 gjyqtarë, gjyqtarët e përzgjedhur janë Nevrie Duka dhe Sokol Pina.

Për çështjen nr. 2 që kërkon 1 gjyqtar është i përzgjedhur gjyqtari Dritan Hasani.

Ilir Toska: Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet**. Ka paraqitur nevojë në 5 çështje, të cilët janë në lëndë penale.

Edhe në këtë rast është i zbatueshëm vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, referuar të cilit Komisioni propozon që:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 5 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jenë Gjykata e Rrethit Gjyqësor

Gjirokastër dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohet për gjykimin e 5 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 3.

Në rast të pranimit të këtyre propozimeve, propozimet vijuese të Komisionit janë: Për 4 çështje, ato nr.1, nr.2, nr.3 dhe nr.4, për të cilat kërkohet 1 gjyqtar, të caktohen 2 gjyqtarë, të cilët të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë (*lapsus, në relacion është Gjirokastër*) Për çështjen nr.5, për të cilën kërkohet 1 gjyqtar, ai të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, për sa kohë trupi gjykues është formuar më herët nga gjyqtarët e rrethit gjyqësor Gjirokastër dhe do duhet të përzgjedhim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë.

Propozimet vijuese kanë të bëjnë me përjashtimet nga shorti, konkretisht për çështjen nr. 3 të përjashtohet nga shorti gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër që ka pengesë ligjore, konkretisht: z. Pëllumb Vehbi.

Në shortimin e çështjes nr.5 të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë që kanë pengesë ligjore, ndërsa janë caktuar më herët për gjykimin e saj, konkretisht: z. Sokol Pina dhe znj. Nevrie Duka.

Nga ana tjetër kemi një propozim për mospërjashtim nga shorti të kryetarit në detyrë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, zotit Arben Dosti, në kushtet e ngarkesës relativisht jo të lartë, të numrit të kufizuar të gjyqtarëve të kësaj gjykate.

Jeni dakord me këto propozime?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Dakord.

Meqenëse Këshilli është dakord me këto propozime, vijojmë me procedurat e shortit elektronik.

Ilir Toska: Ndërpresim për pak momente mbledhjen për shkak të mungesës së internetit dhe do të vijojmë më tej në momentin që do të vijë.

(Disa minuta pauzë.)

Erdhi interneti dhe vazhdojmë me shortin.

Valbona Bako: Atëherë, për 4 çështjet e para nr. 820, gjyqtarja e përzgjedhur Mirela Kore, për çështjen nr. 844, gjyqtare Blerta Çibuku, për çështjen nr. 867, gjyqtari Arben Dosti, dhe për çështjen nr. 870, gjyqtari Pëllumb Vehbi. Më fal, -Suela Dashi.

Enkeleda Doda. Për çështjen nr. 5, Enkeleda Doda.

(Në leximin e emrave të shortit për Gjykatën e Përmetit ka lapsus, pasi gabimisht lexohen emra të tjerë nga ata të rënë nga shorti. Sipas raportit elektronik emrat janë: Suela Dashi, Blerta Çibuku, Suela Dashi, Blerta Çibuku dhe Enkeleda Doda.)

Ilir Toska: Mirë atëherë, mbyllet edhe shorti për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec**. Ka paraqitur nevojë në 2 çështje në lëndë penale. Edhe në këtë rast është i aplikueshëm vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, referuar të cilit Komisioni ka këto propozime:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë dhe numri i gjyqtarëve, të jetë 2.

Në vijim të këtyre propozimeve, Komisioni propozon që të përjashtohet nga shorti kryetarja në detyrë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, zonja Luljeta Kole, po kështu të përjashtohen nga shortimi i çështjeve gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, të cilët janë caktuar më herët në gjykimin e 2 apo më shumë çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, konkretisht zoti Arben Lera, zoti Markelian Kuqo, zonja Eglantina Milkani dhe zonja Sonjela Voskopi.

Jeni dakord me këto propozime?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Meqenëse Këshilli është dakord, vazhdojmë me procedurat e shortit elektronik.

Valbona Bako: Atëherë, për çështjen nr. 12/6/2019 është gjyqtari Ervin Sulaj dhe për çështjen nr... Më dal, për çështjen e parë me nr. 514 është gjyqtari Ervin Sulaj dhe për çështjen e dytë me nr. 222 është gjyqtarja Arjola Kristo.

Ilir Toska: Me pak mbyllet procedurat e shortit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnje**. Ka paraqitur nevojë në 2 çështje, të cilat të dyja janë në lëndë penale. Propozimi i Komisionit në referim të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të

gjqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, është që:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e këtyre 2 çështjeve, të jetë 2.

Kemi vetëm një propozim për përjashtim nga shorti, të kryetarit në detyrë, zëvendëskryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, zoti Durim Hasa.

Jeni dakord?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Dakord.

Meqenëse Këshilli është dakord, vazhdojmë me procedurat e shortit elektronik.

Valbona Bako: Për çështjen nr. 350 gjyqtari Pëllumb Zaimi dhe për çështjen nr. 141 gjyqtarja Lutfie Celami.

Ilir Toska: Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnje.

Vazhdojmë me procedurat e shortit për **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër**. Ka paraqitur nevojë në 1 çështje që është në lëndë penale.

Referuar vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon që:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e kësaj çështjeje, të jetë 3.

Ka propozime vijuese sa i përket përjashtimit nga shorti të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë që ka pengesë ligjore për gjykimin e kësaj çështjeje, zotit Ilir Përdeda.

Nga ana tjetër Komisioni propozon të mos përjashtohet nga shorti kryetarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, në kushtet e numrit të kufizuar të gjyqtarëve të kësaj gjykate, pra zonja Ornela Naqellari.

Jeni dakord me këto propozime?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Vijojmë me procedurat e shortit elektronik.

Valbona Bako: Elsa Ulliri (relatore), Jak Ndoka dhe Ornela Naqellari (anëtarë) – për çështjen e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Ilir Toska: Me kaq mbyllen procedurat e shortit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë**. Ka paraqitur nevojë në 1 çështje në lëndë penale. Edhe në këtë rast është i aplikueshëm vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, referuar të cilit Komisioni propozon që:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e kësaj çështjeje, të jetë 1, saç është edhe nevoja.

Kemi propozim për përjashtim nga shorti vetëm të kryetarit në detyrë, zëvendëskryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, zotit Ded Miri.

Jeni dakord me këtë propozim?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Dakord.

Meqenëse Këshilli është dakord, vazhdojmë me procedurat e shortit elektronik.

Valbona Bako: Gjyqtari Olti Skrame.

Ilir Toska: Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë**. Ka paraqitur nevojë në 1 çështje penale. Edhe në këtë rast është i aplikueshëm vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, referuar të cilit Komisioni ka këto propozime:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e saj, të jetë 1.

Kemi një propozim vetëm sa i përket përjashtimit nga shorti të kryetarit në detyrë, zëvendëskryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, zotit Arbër Çela si dhe sa i përket gjyqtarëve, nga duhet të përzgjidhet një gjyqtar për gjykimin e kësaj çështjeje, që duhet të jenë nga Seksioni Penal i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Jeni dakord me këto propozime?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Dakord.

Meqenëse Këshilli është dakord, vazhdojmë me procedurat e shortit elektronik.

Valbona Bako: Gjyqtari Besmir Stroka.

Ilir Toska: Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë.

Vazhdojmë me procedurat e shortit për **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës.**

Ka paraqitur nevojë në 3 çështje (2 në lëndë penale, 1 në lëndë civile).

Është i aplikueshëm vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, referuar të cilit Komisioni ka këto propozime:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 3 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohet për gjykimin e këtyre 3 çështjeje, të jetë 2.

Kemi si propozim të përjashtohet nga shorti për çështjen nr. 2 gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë që ka pengesë ligjore për gjykimin e saj, konkretisht zoti Sami Ujkashi. Kemi edhe një propozim për mospërjashtim nga shorti të kryetarit në detyrë, zëvendëskryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, zoti Erjon Çela, në kushtet e ngarkesës relativisht jo të lartë të punës në këtë gjykatë dhe numrit të kufizuar të gjyqtarëve të saj.

Jeni dakord me këto propozime?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Dakord.

Vazhdojmë me procedurat e shortit elektronik.

Valbona Bako: Për çështjen nr. 237, gjyqtare Enkeleda Dalipi.

Për çështjen nr. 303, gjyqtari Sami Ujkashi.

Për çështjen nr. 13, gjyqtare Enkeleda Dalipi.

Ilir Toska: Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës.

Vazhdojmë edhe me gjykatën e fundit, **Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë**. Ka paraqitur nevojë në 2 çështje. Edhe në këtë rast është i zbatueshëm vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, referuar të cilit Komisioni ka këto propozime:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e këtyre 2 çështjeve, të jetë 3.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Për çështjen nr.2, për të cilën kërkohen 3 gjyqtarë, ata të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë dhe të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

Për çështjen nr.1, për të cilën kërkohet nga 1 gjyqtar, ai të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e caktuar si anëtar sipas pikës 1.

Kemi propozime për përjashtim nga shorti të kryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, zotit Astrit Shema, po kështu të përjashtohet nga shorti për çështjen nr.1 gjyqtari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë që ka pengesë ligjore, zoti Sokol Ibi, i cili nga ana tjetër të mos përjashtohet nga çështja tjetër, pavarësisht se është kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, në kushtet e ngarkesës relativisht të ulët të punës së kësaj gjykate dhe numrit të kufizuar të saj.

Jeni dakord me këto propozime?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Dakord.

Mirë atëherë, vazhdojmë me procedurat e shortit elektronik.

Valbona Bako: Për çështjen që kërkohet 1 gjyqtar (456), është gjyqtari Ken Dhima (administrative Vlorë).

Për çështjen nr. 733 është përzgjedhur gjyqtari Sokol Ibi (relator) dhe gjyqtarët Etleva Gjamo dhe Ken Dhima (anëtarë).

Ilir Toska: Mekaq mbyllen procedurat e shortit për të gjitha gjykatat. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë mbledhja është e mbyllur për sot.

Takohemi në mbledhjet e tjera.

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor